



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVO CUMHURIYETI**

C.nr. 1591/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, në kontestin e paditësit K. K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Y. K. nga Prizreni, kundër të paditurës Stacioni i Autobusave - Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av.L. B. nga Prizreni, me objekt të padisë pagesën e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **29.05.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit K. K. nga Prizreni, me anë të së cilës kanë kërkuar që të **detyrohet** e paditura Stacioni i Autobusave - Prizren, që të bëjë pagesën e të ardhurave mujore nga 65.00 euro në muaj, duke filluar nga data 01.07.2017, e deri në përfundimin e kësaj çështje juridike, **si tërësisht e pa bazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit K. K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Y. K. nga Prizreni, ka parashtruar padi në gjykatë ndaj të paditurës Stacioni i Autobusave - Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av.L. B. nga Prizreni, duke theksuar se në bazë të njoftimit të paditurit me nr.102/12, të datës 07.07.2017, paditësi është njoftuar se të njëjtit i ndërprehet pagesa e të ardhurave personale, edhe pse ka qenë në marrëdhënie pune te i padituri me kohë të pacaktuar. Me këtë paditësit nuk i ndërprehet marrëdhënia e punës. Paditësi me parashtrësën e datës 01.11.2017 ka kërkuar nga i padituri që të vazhdojë të paguajë të ardhurat personale mujore, mirëpo i njëjti fare nuk është përgjigjur, andaj ka parashtruar padi duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrohet e paditura që të njëjtit t'ia paguajë të ardhurat personale nga data 01.07.2017 deri në përfundimin e kësaj çështje juridike kthejë në vendin e mëparshëm të punës dhe të paguajë ardhurat dhe kontributet për periudhën e largimit të paligjshëm.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit av.Y. K. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë duke bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke propozuar që e paditura të bëjë pagesën e të ardhurave nga 65.00 euro në muaj, duke filluar nga data 01.07.2017, e deri në përfundimin e kësaj çështje juridike. Ndërsa në fjalën e fundit ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, ashtu që të ardhurat mujore paditësit nuk i ndërpriten me aktvendim por me njoftim. Meqenëse paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, atëherë i padituri ka obligim që në vazhdimësi çdo muaj të paguajë nga 65.00 euro. Andaj gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesëpadisë së precizuar. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë nga 135.00 euro për padi dhe për dy seanca gjyqësore, respektivisht shumën e përgjithshme prej 405.00 euro.

Përmes përgjigjes në padi, i autorizuari i të paditurës av.L. B. nga Prizreni, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nuk është e vërtetë se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar. I njëjti ka krijuar marrëdhënie pune me subjektin afarist i cili ka ekzistuar në atë kohë NTU “Kosova Trans” - njesia punuese “Transporti, në vendin e punës mekanik. NTU “Kosova Trans” ka pasur tri njësi punuese: Njesia punuese e Transportit, Njesia punuese “Baza Teknike” dhe Njesia punuese “Stacioni i Autobusave”. Nga AKP-ja në vitin 2006 ka filluar privatizimi i dy njësive punuese dhe atë Baza e Riparimit Teknik dhe Autobusët e Stacionit të Autobusëve. Në fillim të procesit të privatizimit AKM-ja ka vendosur që punëtorët e këtyre njësive në mesin e tyre edhe paditësi të lëshohen në pushim me pagesë, nga njesia punuese e ngelur Stacioni i Autobusave në rast se ka mjete financiare, e cila është dashur të zgjas deri në ratifikimin e kontratës së shitjes së këtyre njësive dhe vetë nëse ka mjete financiare. Privatizimi i njësive “Transporti” është përfunduar në vitin 2007, ndërsa njesia “Baza teknike” është përfunduar në vitin 2009, dhe punëtorët e këtyre duke përfshirë edhe paditësi kanë realizuar pjesën e parë të 20 %. Edhe pas përfundimit të këtyre kontratave punëtorët e këtyre dy njësive kanë realizuar të ardhurat mujore nga 70.00 euro në muaj përfundimisht deri më 30.06.2017, ku me vendim të Këshillit të Punëtorëve të Stacionit të Autobusave është vendosur që të ndërprehen këto paga për shkak të vështirësive të mëdha financiare. Andaj nga të lartcekuarat ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pa bazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurës av.L. B. nga Prizreni, ka mbetur pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se nuk është kontestuese se paditësi ka pasur kontratë për kohë të pacaktuar, mirëpo as kontratë nuk ka qenë e lidhur me të paditurin në këtë rast. Ndërsa në fjalën e tij të fundit, ka theksuar nga provat e administruara vërtetohet se kërkesa e paraqitur me padi nuk ka kurrfarë baze ligjore, andaj ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi 135.00 euro dhe për dy seanca të mbajtura nga 135.00 euro..

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka zhvilluar procedurë dhe ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse si në vijim: Parashtrësën e këtij paditësit K. K. nga Prizreni, drejtuar këtij të paditurës me nr.201, të dt.01.11.2017; Njoftimin e Stacionit të autobusëve në Prizren, nr.102/12, të dt.07.07.2017; Njoftimin e Agjencisë Kosovare të

Mirëbesimit, nr.PZ/235/06, të dt.07.04.2006; Njoftimin e AKM, të dt.27.04.2007; Njoftimin e AKM nr.PZ/631/07 të dt.05.11.2007; Njoftimin e AKP-së, të dt.24.07.2009; Njoftimin e AKP-së, nr.792, të datës 26.02.2013, si dhe Procesverbalin Këshillit të punëtorëve të stacionit të autobusëve të dt.06.07.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga leximi i Parashtrës së këtu paditësit K. K. nga Prizreni, drejtuar këtu të paditurës me nr.201, të dt.01.11.2017, gjykata ka konstatuar se me të njëjtën këtu paditësi i është drejtuar të paditurës vazhdimin e pagesës së rrogës prej datës 01.07.2017.

Nga leximi i Njoftimit të Stacionit të autobusëve në Prizren, nr.102/12, të dt.07.07.2017, gjykata ka konstatuar se me të njëjtin është njoftuar këtu paditësi se nga data 01.07.2017 do ti ndërprehet pagesa e të ardhurave së bashku me puntorët tjerë.

Nga leximi i Njoftimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, nr.PZ/235/06, të dt.07.04.2006, gjykata ka konstatuar se e njëjta ka njoftuar lidhur me privatizimin e N.SH."Kosova Trans" në njësi të veçanta.

Nga leximi i Njoftimit të AKM, të dt.27.04.2007, gjykata ka konstatuar se Agjencia e ka njoftuar NT Kosova trans që puntorët e njësive punuese Transporti dhe Baza Teknike duhet të paguhen.

Nga leximi i Njoftimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, nr.PZ/631/07 të dt.05.11.2007, gjykata ka konstatuar se e njëjta ka njoftuar lidhur me gjendjen e puntorëve të NSH Kosova Trans.

Nga leximi i Njoftimit të AKP-së, të dt.24.07.2009, gjykata ka konstatuar se kontrata e shitjes për Njesinë e Mirëmbajtjes dhe Transportit, është përmbyllë me datën 08.04.2009.

Nga leximi i Njoftimit të AKP-së, nr.792, të datës 26.02.2013, gjykata ka konstatuar se me të njëjtit është njoftuar se Baza e Riparimit Tenik dhe Transporti janë privatizuar në vitin 2007, përkatasisht 2009.

Nga leximi i Procesverbalit të Këshillit të punëtorëve të stacionit të autobusëve të dt.06.07.2017, gjykata ka konstatuar se në këtë mbledhje është vendosur ndërpreja e pagave

mujore për të punësuarit në pritje, të njesive punuese Baza Teknike dhe Transporti, të cilat janë privatizuar.

Në këtë çështje juridiko-kontestimore sipas gjykatës duhet të zbatohen dispozitat ligjore të parapara në Ligjin të Punës, nr.03/L-212, i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë. Në këtë drejtim në nenin 67 të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë, në paragrafin 1 është paraparë se “*Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: 1.1.kontrata e punës ndërpritet me vdekjen e të punësuarit, 1.2. me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit, 1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës...*”. Sipas nenit 70 para. 1 nënpar.1.6 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr.03/L-2121, është e paraparë se “*punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit atëherë kur: i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve, apo kur performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim*”. Ndërsa në nenin 78 të ligjit të Punës nr.03/L-212, par.1 është paraparë se “*I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të tij*”. Në nenin 78 par.2 është paraparë se “*Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës*”. Ndërsa në nenin 79 të të njëjtit ligj është paraparë se “*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2 i këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente*”.. Poashtu me nenin 85 par.1 të po këtij ligji është paraparë se “*Për shkelje të detyrave të punës, të punësuarit do ti shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese:1.1. Vërejtja me gojë; 1.2. Vërejtja me shkrim; 1.3. Ulja në Pozitë; 1.4.Suspendim i përkohshëm; dhe 1.5. Ndërprerje e marrëdhënies së punës.*” Në nenin 21 par.4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Nr.04/L-161 ku parashihet se “*I punësuarit mund të refuzojë urdhëresën për punë, nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rrezikudhe nuk krijohen kushtet normale për punë*”

Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “*Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...*”.

Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjygjëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazë dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, e njëjta duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar se këtu paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatsisht ish NTU "Kosova Trans" – njësia punuese "Baza Teknike" në vendin e punës si mekanik, me kontratë pune në kohë të pacaktuar. Në vitin 2007 përkatsisht 2009 njësitë punuese të ish NTU "Kosova Trans" - njësia "Transporti" dhe njësia "Baza e Riparimit Teknik" - *ku ka qenë i caktuar si puntorë tani paditësi* është privatizuar nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të gjithë punëtorët janë dërguar në pushim me pagesë, me kusht që të paguhen deri në momentin e shitjes së këtyre njësive. Mirëpo edhe pas shitjes së këtyre njësive punuese si aset i mbetur nga ana e NTU "Kosova Trans" tani ka mbetur këtu e paditura Stacioni i Autobusave në Prizren, e cila edhe pas privatizimit të njësive punuese ka vazhduar pagesën e punëtorve të njësive të lartcekura deri më 01.07.2017, ku pas mbledhjes së mbajtur i ka njoftuar të gjithë punëtorët në pritje se për shkak të gjendjes së vështirë financiare të ndërmarrjes do të ndërprehet pagesa mujore, pasi që këto njësi tani më janë privatizuar. Këtu paditësi me datën 31.10.2017, ka parashtruar parashtrësë – kundërshtim, duke e kundërshtuar njoftimin e të paditurës për ndërprerjen e pagave mujore, për të cilën parashtrësë fare nuk ka marrë përgjigje nga ana e këtu të paditurës. Pas kësaj të paditurit kanë parashtruar në gjykatë padi duke kërkuar pagesën e të ardhurave mujore duke filluar nga data 01.01.2017 deri në vendosjen e gjykatës për këtë çështje..

Sipas vlerësimit të gjykatës nuk ekzistojnë kushtet ligjore, për aprovimin e kërkesëpadiës së paditësit, pasi që paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, por përmes njoftimit të këtu të paditurës vetëm i është ndërprerë pagesa mujore, e cila i është paguar nga ana e këtu të paditurës, ndërsa që nga ana tjetër paditësi fare nuk ka kërkuar anulimin e njoftimit të lartcekur të të paditurës me të cilën është ndërprerë pagesa e të ardhurave mujore. Poashtu sipas vlerësimit të gjykatës paditësi është dashur që të kundërshtojë vendimin e ish punëdhënësit për ti dërguar në pushim me pagesë, pasi që me atë rast është vendosur që pagesa të gjithë puntorëve përfshirë edhe paditësin të bëhet deri në momentin e shitjes së ndërmarrjes - njësisë punuese. Në këtë drejtim edhe vet këtu e paditura ka vazhduar pagesën e të ardhurave mujore për të punësuarit në pritje edhe pas shitjes përkatësisht, privatizimit të njësive punuese - "Baza e Riparimit Teknik" aty ku ka qenë i punësuar këtu paditësi, ndërsa që për këtë ka pas obligim që ti paguajë deri në kohën e privatizimit. Dihet botërisht se pas procesit të privatizimit të gjithë punëtorët e ndërmarrjes së privatizuar i kanë realizuar të drejtat e tyre, e që ashtu ka ndodhur edhe me punëtorët e kësaj ndërmarrje, që do të thotë se të njëjtit janë pajtuar që të hyjnë në listën e punëtorëve në pritje deri në shitjen e ndërmarrjes, andaj dhe për këto arsye kërkesëpadia e paditësit nuk ka mundur të aprovohet, përkatsisht e njëjta u deshtë që të refuzohet si e pa bazuar.

Nga të gjitha të cekurat më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit, ashtu siç është cekur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është e pathemeltë, andaj dhe gjykata u deshtë që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi, pasi që objekt kontesti ka qenë pagesa e të ardhurave personale, e jo kthimi në vendin e punës apo realizimi i ndonjë të drejte tjetër nga marrëdhënia e punës.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.4 të LPK-së, pasi që paditësit nuk kanë pasur sukses në gjykim, ndërsa i padituri i ka kërkuar shpenzimet, por pasi që kontesti ka pasur të bëjë me pagesën e të ardhurave personale, gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale..

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN

C.nr.1591/17, datë 29.05.2018

Sekretarja juridike
Kujtesa Uka

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.